

Seancës Pleuale
27/11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2018 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, shoqëruar me relacionin përkatës.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Enkelejd ALIBEAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pika 1 ndryshohet si vijon: “*“Data e zgjedhjeve” janë ditët gjatë të cilave ushtrohet e drejta e votimit për Kuvendin e Shqipërisë ose organet e qeverisjes vendore, të përcaktuara me dekret të Presidentit të Republikës”*”.

Pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me përmbajtje si më poshtë:

“*Zona e Administrimit Zgjedhor” ZAZ është nënndarja e zonës zgjedhore me qëllim administrimin e zgjedhjeve për Kuvend dhe zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore e cila krijohet me vendim të KQZ sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod”*”.

Pas pikës 7/1 shtohet pika 7/2 me përmbajtje si më poshtë:

“*Vend votimi” është vendi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në të cilin realizohet procesi i votimit, në një ose më shumë qendra votimi”*”.

Në pikën 18 hiqen fjalët “*...në zonën zgjedhore, si dhe në shkallë vendi,...*”.

Pika 25, Ndryshohet si vijon “*“Zonë zgjedhore” është tërësia e territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend dhe bashkia për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”*”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

në pikën 1 hiqen fjalët “*...për zonën zgjedhore përkatëse...*”

në pikën 4, në fjalinë e parë hiqen fjalët "...pranë komisioneve zgjedhore..."; fjalët "...zona zgjedhore." zëvendësohen me fjalët "...zona të administrimit zgjedhor."; hiqet fjalia e fundit e pikës.

Neni 3

Në nenin 8 pas fjalëve "...në të gjithë territorin e vendit..." shtohen fjalët "... dhe jashtë tij...".

Neni 4

Në nenin 9, pika 1 ndyshohet si vijon:

"Data e zgjedhjeve për Kuvendin caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, sipas rregullave të parashikuara në nenin 65 të Kushtetutës. Zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen në dy ditë të njëpasnjëshme, duke filluar të shtunën dhe përfunduar të dielën, brenda periudhës zgjedhore të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji."

Neni 5

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Në pikën 1 fjala "... data..." zëvendësohet me fjalën "...datat,,,".

Në pikën 2 fjala "... data..." zëvendësohet me fjalën "...datat,,,".

Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"2/1. Në qendrat e votimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë orari i votimit fillon sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të këtij neni por në çdo rast përfundon në të njëjtën orë me përfundimin e orarit të votimit në qendrat e votimit në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht ndryshimeve orare."

Neni 6

Neni 24 ndryshohet si vijon:

1. Zgjedhësit me të drejtë vote, të cilët janë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ushtrojnë të drejtën e votës në shtetin e qëndrimit.
2. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin për zgjedhësit me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me vendim të KQZ-së brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.
4. Dispozitat

Neni 7

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

1. Për të ushtruar të drejtën e votës në shtetin e qëndrimit zgjedhësit duhet të regjistrohen në "listën e zgjedhësve me qëndrim jashtë Shqipërisë". Regjistrimi mund të kryhet në çdo kohë, ndërmjet periudhave zgjedhore, por në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj nga data e zgjedhjeve të caktuara nga Presidenti i Republikës. Kërkesa për regjistrim mund të bëhet vetëm në rrugë elektronike.
2. Procedura e regjistrimit miratohen me vendim nga KQZ brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Lista e shtetasve që ushtrojnë të drejtën e votës në shtetin e qëndrimi hartohet me të dhënat si më poshtë:
 - a. emri;
 - b. atësia;
 - c. amësia;
 - ç. mbiemri;
 - d. datëlindja;

- dh. numri personal i identifikimit;
 - e. vendlindja;
 - ë. shteti i qendrimit;
 - f. qytetit i qendrimit;
 - g. gjinia.
4. Bazuar në listën me të dhënat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni hartohet lista përfundimtare e zgjedhësve që ushtrojnë të drejtën e votimit në vendin e qëndrimit dhe listat përkatëse në bazë të shtetit të qëndrimit.
 5. Jo më vonë 30 ditë nga përfundimi i afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni KQZ miraton me vendim listën përfundimtare të shtetasve shqiptare me qëndrim jashtë Shqipërisë të cilët janë regjistruar si dhe listën e shteteve në të cilat do të realizohet votimi jashtë Shqipërisë. Vendimi i KQZ së bashku me listën i dërgohet ministrisë përgjegjëse për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
 6. Ministria përgjegjëse për gjendjen civile, brenda 15 ditëve nga marrja e listës sipas pikës 5 të këtij neni, përditëson listën zgjedhësve, që ushtrojnë të drejtën e votës në Shqipëri, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.

Neni 8

Pika 1 e nenit 25 ndryshohet si vijon:

“1. Votimi për zgjedhësit me banim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë Shqipërisë zhvillohet në datën e zgjedhjeve të përcaktuar me dekret të Presidentit të Republikës dhe sipas orareve të parashikuara në këtë Kod.”

Pika 2 e nenit 25 shfuqizohet

Neni 9

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 27.

Zonat e administrimit zgjedhor jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

1. Në të gjitha shtetet në të cilat regjistrohet një numër zgjedhësish, me qëndim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë Shqipërisë, më i madh se 5.000, ngrihet një zonë e administrimit të zgjedhjeve.
2. Juridiksioni territorial i ZAZ-ve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si rregull është i njëjtë me territorin e shtetit në të cilin ngrihet. Përyjashtimisht nga ky rregull KQZ mund të vendosë ngritjen e ZAZ me juridiksion territorial në disa shtete kur numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në këto shtete është më i madh se 5.000.
3. Vendimi për ngritjen e ZAZ jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë merret nga KQZ jo më vonë se 4 muaj nga data e caktuar e zgjedhjeve.

Neni 10

Në pikën 3 të nenit 46 fjalët “...nenin 24...” zëvendësohen me fjalët “... nenet 24 dhe 24/1...”

Neni 11

Pas nenit 62 shtohen nenet si më poshtë:

Neni 62/1

Caktimi i qëndrave të votimit jashtë vendit

1. Si rregull qëndrat e votimit jashtë vendit caktohen në selitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet përkatëse.
2. Në rast se në ZAZ përkatëse nuk ka seli diplomatike dhe duhet të caktohet një vend votimi, apo në rastin kur ka seli diplomatike dhe duhet të caktohet më shumë se një vend votimi, KQZ, me propozim të përfaqësuesit diplomatik të Republikës së Shqipërisë, në atë shtet apo në shtetin më të afërt kur i pari mungon, dhe miratim të KZAZ përkatëse, jo më vonë se 3 muaj nga data e zgjedhjeve, përcakton vende të tjera për realizimin e procesit të votimit në datat e caktuara të zgjedhjeve. Vendimi i KQZ i njoftohet brenda 10 ditëve Ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme e cila në bashkëpunim me përfaqësuesit diplomatikë merr masa për lidhjen e marrvëshjeve me shtetet në të cilat janë caktuar vendet e votimit dhe nëse është e nevojshme edhe marrjen me qera të ambienteve të përcaktuara për realizimin e procesit të votimit.
3. Lista e vendeve të votimit, qendrave të votimit të përfshira në to dhe vendndodhja e tyre publikohet 60 ditë përpara datës së caktuar të zgjedhjeve.
4. Për ndryshimin e vendit të votimit zbatohen dispozitat e këtij kodi për ndryshimin e vendit të qendrës së votimit.

Neni 12

Në nenin 63, shtohet pika 3/1 si më poshtë:

3/1. Kandidatët për kryetar bashkie mund të regjistrohen dhe si kandidatë për këshillat vendorë në listën shumëemërore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

Neni 13

Në nenin 67 fjalia e fundit e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

“Në rast se subjekti zgjedhor është koalicioni i përbërë nga emri i kandidatit përcaktohet dhe shpallëhet partia politike propozuese e kandidatit.”

Neni 14

Neni 74 ndryshohet si vijon: “Për zgjedhjet për Kuvend, Republika e Shqipërisë konsiderohet një zonë zgjedhore.”.

Neni 15

Neni 75 Shfuqizohet

Neni 16

Neni 76 Shfuqizohet

Neni 17

Në nenin 77, pika 2, pas fjalës “...medias...”, shtohet shprehja “...dhe platformave elektronike...”.

Neni 18

Në nenin 78, bëhet ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

Pika 2, pas shprehjes “...operatorët radiotelevizive...” shtohet shprehja “...platformave elektronike...”.

Pika 6, shprehja “...institucionet publike.” zëvendësohet me shprehjen “...personat juridikë publikë.”.

Pika 9, pas fjalës “...organizojnë...” shtohet shprehja “...ose të marrin pjesë...”.

Pas pikës 10, shtohet pika 11 me përmbajtje si më poshtë:

*“11. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të hapin zyra elektorale jo më herët se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Numri i zyrave elektorale nuk mund të jetë më i madh se një zyrë për njësi administrative. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me përmbajtje si më poshtë:
“12. Dispozitat e këtij kodi zbatohen edhe për fushatën e subjekteve zgjedhore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.”*

Neni 19

Në nenin 81, ndryshon emërtimin dhe bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

“Edicionet informative të radiotelevizionit publik dhe në radiot dhe televizionet private me licensë kombëtare

- 1. Në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik si dhe radiot dhe televizionet private me licensë kombëtare janë të detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend.*
- 2. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie ose të një koalicioni, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve urdhëron reduktimin në të njëjtën masë të kohës në dispozicion të partisë ose koalicionit politik ose kompensimin e partive apo koalicioneve të tjera politike me minutazh shtesë brenda 48 orëve.*
- 3. Transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore, llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor.*
- 4. Për pasqyrimin e veprimtarive të partive joparlamentare radiotelevizioni publik radiotelevizioni publik si dhe radiot dhe televizionet private me licensë kombëtare zbaton kriteret profesionale të lajmit. Koha në dispozicion nuk mund të jetë më e madhe se koha e dhënë për partitë parlamentare, të cilat kanë marrë jo më pak se 20 për qind të vendeve në Kuvend.*
- 5. Brenda edicioneve informative gazetarët e radiotelevizionit publik radiotelevizioni publik si dhe radiot dhe televizionet private me licensë kombëtare e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike.*
- 6. Në rast të shkeljes së kërkesave të përcaktuara në këtë nen, Komisioneri gjëbë, sipas rastit dhe shkallës së përgjegjësisë, me 100,000 lekë reporterin që ka përgatitur kronikën, me 300,000 lekë redaktorin përgjegjës, me 500,000 lekë drejtorin e informacionit dhe me 800,000 lekë drejtorin e përgjithshëm.*
- 7. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga drejtoria e financës e radiotelevizionit publik. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij.*

Neni 20

Në nenin 84, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

- 1. Në radiot dhe televizionet private, pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative. Radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre. Informacionet mbi aktivitete të fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative, bazuar në*

materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore, duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.

2. Radiot dhe televizionet private, në edicionet e tyre të zakonshme dhe të posaçme informative, duhet të respektojnë kushtet e mëposhtme:
 - a. minutazhi politik i edicioneve informative ndahet në raporte kohore, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 81 të këtij Kodi. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse;
 - b. transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike, qendrore ose vendore gjatë periudhës së ndalit sipas nenit 91 të këtij Kodi, do të llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor, të cilit i përket titullari i institucionit, nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor. Radiotelevizioni privat është i detyruar të vendos në dispozicion të subjekteve të tjera të njëjtën kohë trasmetimi. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse.
 - c. për pasqyrimin e veprimtarive të partive joparlamentare dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, radiot dhe televizionet private zbatojnë kriteret profesionale të lajmit;
 - ç. brenda edicioneve informative, gazetarët e kanë të ndaluar propagandën, komentet ose qëndrimet politike. Në rast shkeljeje, KQZ-ja e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,000,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 2,500,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse.
 - d. Media audiovizive përgatit lajmet në liri të plotë editoriale. Kur për shkaqe objektive media nuk është në gjendje të ndjekë veprimtari të veçanta zgjedhore, ajo lejohet të shfrytëzojë dhe përzgjedhë pamje filmike nga regjistrimet e plota të servitura nga subjektet zgjedhore, me kushtin që ta shoqërojë lajmin me shënimin “materiali filmik servitur nga subjekti...”.
3. Radiot dhe televizionet private kanë të drejtë të organizojnë debate zgjedhore midis partive politike ose kandidatëve konkurrentë. Në organizimin dhe zhvillimin e debatit, radiotelevizionet private janë të detyruara të ruajnë baraspeshën mes partive politike në debat. Në rast të shkeljes së raporteve të pasqyrimin në favor të një partie apo një kandidati, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse
4. Vetëm subjektet zgjedhore të regjistruara për zgjedhje kanë të drejtë të transmetojnë reklama politike gjatë periudhës zgjedhore në radiot, televizionet apo mediat audiovizive private, qofshin këto

numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit. Reklamat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit, sipas marrëveshjes individuale të secilës parti me operatorin radioteleviziv. Reklama politike duhet të identifikojë qartë subjektin porosites. Në rast se reklama politike nuk është identifikuar qartë, Komisioneri urdhëron pezullimin e menjëhershëm të transmetimit të saj derisa të bëhet identifikimi i kërkuar nga kjo pikë. Në rast të mos zbatimit të urdhërit të tij nga ana e në radiove, televizioneve apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse

5. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 120 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rast të mos zbatimit të kësaj dispozite nga ana e në radiove, televizioneve apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse
6. Për zgjedhjet në Kuvend radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, sipas këtij neni, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës së parashikuar në pikën 5 të këtij neni t'ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore nga ana e radiove dhe televizioneve private llogaritet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohen KQZ-ja, enti rregullator për mediat audiovizive dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse.
7. Reklamat politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 deri 18:00 dhe nga ora 21:00 deri 24:00 të programit ditor.
8. Reklamat për kandidatët për kryetar të njërive të qeverisjes vendore llogariten në kohën e subjektit politik që ata përfaqësojnë.
9. Për partitë joparlamentare dhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, radiot dhe televizionet private vënë në dispozicion kohë transmetimi shtesë për reklamat mbi kohën që zbatohet, sipas pikës 5 të këtij neni. Koha e transmetimit të reklamave për secilën parti joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk mund të jetë më e madhe se 20 minuta për gjithë fushatën zgjedhore. Për partitë joparlamentare dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit zbatohen tarifa të njëjta me ato që zbatohen për partitë parlamentare, si dhe kritere të njëjta për kohën falas, sipas pikës 6 të këtij neni. Në rast shkeljeje, KQZ-ja gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 2,000,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,500,000 lekë. Vendimi i KQZ-së përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit gjyqësor. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast shkeljeje, KQZ-ja urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv vendor për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse.

10. Institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, dita e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve, u ndalohen reklamat, me përjashtim të atyre që i shërbejnë qëllimit të ndërgjegjësimit të zgjedhësve për aspekte të procesit zgjedhor ose njoftime të tjera të parashikuara nga ligji. Në rast të mos zbatimit të kësaj dispozite nga ana e në radiove, televizioneve apo mediat audiovizive private, qofshin këto numerike, kabllore, analoge, satelitore apo të çdo lloj forme dhe mënyre të transmetimit të sinjalit, Komisioneri, kryesisht ose me propozimin e KZAZ-ve, e gjobit operatorin radioteleviziv vendor me 1,500,000 lekë dhe operatorin radioteleviziv kombëtar me 3,000,000 lekë. Vendimi i Komisionerit përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast përsëritjeje të shkeljes, Komisioneri urdhëron entin rregullator për mediat audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18:00 e ditës pasardhëse

Neni 21

Në nenin 86, bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

Gërma "c" shfuqizohet.

Gërma "ç" shfuqizohet.

Neni 22

Neni 90 shfuqizohet.

Neni 23

Në nenin 91, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Pika 2, fjalia e dytë riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime të zgjedhore, si dhe përdorimi brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

Pika 3, riformohet me përmbajtje si më poshtë:

Nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve, ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në personat juridikë publikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara caktimit të datës së zgjedhjeve nga personat juridikë publikë në përmbushje të misionit të tyre. Në këtë rast, personi juridik publik duhet të njoftojë KQZ-në me shkrim brenda një afati 5-ditor nga data e kryerjes së emërimit, pushimit, lirimit apo transferimit. Njoftimi duhet të përmbajë në mënyrë të arsyetuar shkaqet e përligjura.

Pika 4 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re ose deri në betimin e kryetarit të Bashkisë, sipas rastit, pas zgjedhjeve, ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale ose penale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

Pika 5 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Në përputhje me ndalimet e parashikuara në këtë nen, Komisioni Rregullator, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nxjerr një udhëzim të hollësishëm për të përcaktuar përdorimin e burimeve publike dhe rastet e ndalimit.

Neni 24

Në nenin 92, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Pika 1 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Personat juridikë publikë janë të detyruar të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Konsiderohen veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut ose të medias ose të pasqyruara në platformat elektronike.

Pika 2 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të personit juridik publik. Raportimi duhet të kryhet jo më vonë 10 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

Në pikën 4, fjalia e tretë, fjala "...dy..." zëvendësohet me fjalën "...pesë...".

Pika 5 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Veprimtaritë e ndaluara nga KQZ-ja nuk lejohet të publikohen në media ose platformat elektronike. Publikimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë ngarkon me përgjegjësi personin që realizon publikimin.

Pika 6 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të personave juridik publikë ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja, ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të personit juridik publik kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

Pika 7 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Rregullat e detajuara për raportimin e veprimtarive publike, ndalimin e veprimtarive që përbëjnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, si dhe masat që merren ndaj shkelësve të këtij neni, përcaktohen me vendim të Komisionit Rregullator, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 25

Neni 92/1 shfuqizohet.

Neni 26

Neni 92/2 shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin 92/3, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1, shprehja "...60 ditëve..." zëvendësohet me shprehjen "...90 ditëve...".

Në pikën 2, gërma "a" shfuqizohet.

Në pikën 2, gërma "c" shprehja "...dhe në pikën 4 të nenit 92/2 të këtij ligji" hiqet.

Në pikën 3, gërma "d" shfuqizohet.

Neni 28

Në nenin 92/4 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1, shprehja "Jo më vonë se gjatë muaj para datës së zgjedhjeve..." zëvendësohet me shprehjen "Jo më vonë se 10 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve...".

Pika 2 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Komisioni Rregullator, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miraton me udhëzim kriteret për përzgjedhjen e monitoruesve dhe objektin e monitorimit. Monitorimi nënkupton verifikimin e përmbushjes së detyrimeve sipas këtij ligji të personave juridikë publikë, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të tyre.

Neni 29

Në nenin 92/6, bëhen ndryshimet si më poshtë:
Pika 1, fjalia e tretë *shfuqizohet*.
Pika 5, shprehja "...apo dhuruesit..." *shfuqizohet*.

Neni 30

Pas nenit 93 shtohet neni 93/1 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 93/1

Selitw e KZAZ jashtw vendit.

1. *Selitw e KZAZ jashtë vendit caktohen në selitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet përkatëse.*
2. *Në rast se në ZAZ përkatëse nuk ka seli diplomatike KQZ, me propozim të përfaqësuesit diplomatik të Republikës së Shqipërisë, në atë shtet apo në shtetin më të afërt kur i pari mungon, jo më vonë se 4 muaj nga data e zgjedhjeve, përcakton vend tjetër për ngritjen e selisw sw KZAZ. Vendimi i KQZ i njoftohet brenda 10 ditëve Ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme e cila në bashkëpunim me përfaqësuesit diplomatikë merr masa për marrjen me qera të ambientit të përcaktuar.*
3. *Lista e selive tw KZAZ vendndodhja e tyre publikohet 90 ditë përpara datës së caktuar të zgjedhjeve.*

Neni 31

Në nenin 98 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Nw pikwn 3 tw nenit 98 as pas fjalwve "...shkronja nistore..." hiqen fjalwt "...dhe emri i kryetarit të parties." dhe shtohen fjalwt "..., emri i kryetarit tw partisw, ose nw rastin e koalcioneve zgjedhore, emri i kryetarit tw partisw udhwheqws tw koalicionit."

Shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:

4/1. Fleta e votimit për zgjedhjet për pushtetin lokal duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët për Këshill Bashkiak të subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit dhe konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.

Neni 32

Neni 124 riformulohet me përmbajtje si më poshtë

1. *Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KAS kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.*
2. *Kundër vendimit të KZAZ-së për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njëjësive të qeverisjes vendore nën juridiksionin e saj, të marrë sipas nenit 122 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.*
3. *Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankimi po në KAS jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse*

të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

4. Në çdo rast ankimi për pavlefshmëri, sipas nenit 160, dhe ankimi për ndryshimin e tabelës së rezultatit paraqitet në të njëjtën kërkesë ankimore, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në kërkesë përcaktohen qendrat e votimit, për të cilat kërkohet ndryshimi i rezultatit apo pavlefshmëria.
5. Të drejtën e ankimit, sipas pikës 1 të këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, si dhe subjektet e përmendura në nenin 6 të këtij Kodi, kundër refuzimit të kërkesave për akreditim të vëzhguesve, në rastet kur akreditimi i vëzhguesve u delegohet KZAZ-ve. Vendimet e Komisionerit për regjistrimin apo refuzimin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, të marra në zbatim të pjesës IV të këtij Kodi, ankimohen në KAS. Kundër vendimit të KAS mund të bëhet ankim sipas kreut I të pjesës XI të këtij Kodi në Kolegjin Zgjedhor.
6. Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KAS shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

Neni 33

Neni 134 riformulohet me përmbajtje si më poshtë

1. Shqyrtimi administrativ për kërkesën ankimore zgjedhore zhvillohet nga KAS në seancë plenare.
2. Relatori i përcaktuar nga shorti për kërkesën ankimore drejton seancën plenare.
3. Afatet për kryerjen e veprimeve hetimore administrative caktohen nga KAS në konsultim me palët.
4. Shqyrtimi i kërkesës ankimore përpara KAS bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes.
5. Gjatë shqyrtimit të kërkesës ankimore mbahet procesverbal nga një punonjës i caktuar nga KQZ-ja dhe, për sa është e mundur, seanca plenare regjistrohet me zë dhe/ose me figurë. Në procesverbal shënohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e palëve dhe pasqyrohen në mënyrë të plotë provat që merren, si dhe urdhrat e vendimet e ndërmjetme të KAS.

Neni 34

Neni 135 riformulohet me përmbajtje si më poshtë

1. Në ditën dhe në orën e caktuar palët njoftojnë sekretarinë e ngritur posaçërisht nga KQZ-ja për praninë e tyre.
2. Përpara fillimit të seancës, administrata e KQZ-së thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton të zënë vendet e caktuara.
3. Pasi deklarohet çelja e seancës së shqyrtimit, verifikohet legjitimitimi procedural i palëve, sipas nenit 133 të këtij Kodi.
4. Në qoftë se në ditën dhe në orën e caktuar njëra ose disa prej palëve nuk paraqiten, seanca zhvillohet pavarësisht pjesëmarrjes së tyre.
5. Përpara se palët të paraqesin pretendimet e tyre, KAS:
 - a. pranon ose refuzon deklaratimet individuale të anëtarëve të KAS për ekzistencën e konfliktit të interesit, sipas nenit 17 pika 3 të këtij Kodi;
 - b. vendos lidhur me kërkesat e palëve për përjashtimin e anëtarëve të KAS për ekzistencën e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 17 pika 4 të këtij Kodi;
 - c. vendos lidhur me kërkesat e palëve apo të relatorit për mosshqyrtimin e çështjes për mungesë kompetence të KAS ose kalim të afatit për ankim.
6. Pasi merr vendim për kërkesat paraprake të palëve dhe në rast se ato nuk sjellin pushimin e shqyrtimit administrativ, KAS shqyrton dhe zgjidh çështjen në themel, pa ndërprerë seancën. Seanca ndërpritet vetëm kur është e nevojshme marrja e provave nga të tretë.

Neni 35

Neni 136 riformulohet me përmbajtje si më poshtë

1. Në përfundim të veprimeve të përcaktuara në nenin 135 të këtij Kodi, KAS fton palët të paraqesin pretendimet e tyre dhe:
 - a. të japin shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në ankim;
 - b. të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Llojet e provave përcaktohen në Kodin e Procedurës Civile; dhe
 - c. të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre.
2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KAS, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjyqimit.
3. Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KAS, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KAS. KAS është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara.
4. KAS mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara. Arsyetimi i KAS për refuzimin e marrjes së provës jepet i detajuar në vendimin përfundimtar. KAS nuk mund të refuzojë kërkesën për prova, të bërë sipas pikës 3 të këtij neni.
5. Paraqitja e pretendimeve të palëve fillon me ankuesin dhe vijon me palët e interesuara, sipas radhës së caktuar nga Relatori i shqyrtimit të ankesës ankimore. Kjo radhë ruhet gjatë gjithë procesimit.
6. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në këtë nen, kur KAS çmon se një fakt, rrethanë ose ngjarje ka ndodhur, ajo merret si provë, pavarësisht nëse nuk është pasqyruar në ndonjë dokument zgjedhor.

Neni 36

Neni 137 riformulohet me përmbajtje si më poshtë

1. KAS u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
2. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas pikës 1 të këtij neni, me marrjen e kërkesës së KAS dhe brenda afatit dhe mënyrës të përcaktuar në të.
3. Në qoftë se organi i administratës publike, pa shkaqe të ligjshme, refuzon plotësimin e kërkesës ose nuk e plotëson atë në afat, Komisioneri pas referimit nga ana e KAS, në përputhje me nenin 172 të këtij Kodi, gjobit ose, sipas rastit, kallëzon për ndjekje penale personat përgjegjës të përcaktuar në nenin 4 të këtij Kodi.

Neni 37

Neni 162 ndryshohet si vijon:

1. Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë.
2. Numri i votave të vlefshme të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror të mandatit të fundit. Hapi nga njëri pjesëtues tek tjetri është 1. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.
3. Kur subjekti zgjedhor është kandidat i propozuar nga zgjedhësit, votat e tij pjesëtohen vetëm me pjesëtuesin 1.

4. Herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, përfshirë edhe rezultatin e pikës 3 të këtij neni, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Në rast se herësi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të renditet numri i plotë i mandateve për Kuvend.
5. Një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni. Në rast se për vendin e fundit në listën e përcaktuar në pikën 4 të këtij neni rezultojnë dy apo më shumë subjekte me të njëjtin herës, mandati i jepet atij subjekti që ka numrin më të madh të votave dhe nëse ato kanë numër të barabartë votash, atëherë përcaktohet me short midis atyre subjekteve. Shorti hidhet publikisht në KQZ, në prani të subjekteve të interesuara”.

Neni 38

Neni 163 ndryshohet si vijon:

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.
2. Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat të listës shumë emërore.
3. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.
4. Nëse pas shpërndarjes së mandateve sipas përcaktimeve të pikës 2 kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku 30% nga numri i përgjithshëm i vendeve të subjektit politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga një kandidat i radhës i gjinisë së nënpërfaqshuar në listën e rirrenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë e nënpërfaqshuar të jetë së paku 30%.
5. Përlllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, miratohet me vendim. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.

Neni 39

Në nenin 164, pika 1, pas fjalëve “...në nenin...” shtohen fjalët “...6/1 dhe...”.

Neni 40

Në nenin 166, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 162 dhe 163 të këtij Kodi. Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në listën e kandidatëve, sipas votës parapëlqyese, duke filluar nga numri rendor një.”

Neni 41

Neni 167 togjalëshi “...pika 7 e neni 163...” zëvendësohet me togjalëshin “...pika 5 e neni 163...”.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA